



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr. 15/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit Sh. Sh sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.1371/16 të dt.28.12.2016, për shkak të veprës penale: rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 1 lidhur me par 6 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë të pandehurit Sh. Sh dhe të prokurorit të shtetit Lumturije Hoxha me dt.18.1.2018 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri Sh. Sh i lindur me dt.03.4.1962 në fsh. R. Komuna e P. , tani me vendbanim në P. rruga..... pa nr, i biri O dhe nënës N e gjinisë E, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës , kinse i pa dënuar më parë , gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me dt. 25.5.2016 rreth orës 11:40 në rrugën “M. T” , në P. nga pakujdesia ka shkelur nenin 42 par 1 të Ligjit mbi sigurinë e Komunikacionit rrugorë të Kosovës që ka rezultuar me lëndime të lehta trupore për të dëmtuarën A. K , në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri gjersa ka qenë duke drejtuar automjetin e tij të llojit Daimler Chrysler , me ngjarë krem , me targa të regjistrimit , në momentin kur ishte i parkuar në parkingun e taksistëve fillon të lëvizë mbrapa, e ku këtë veprim e ka ndërmarrë pa u bindur se mund ta bëjë në mënyrë të sigurve dhe pa i penguar pjesëmarrësit e tjerë të komunikacionit , ashtu që nuk i kushton vëmendje veturës së tipit Audi A4 , me targa të regjistrimit , të cilën e drejtonte i dëmtuari K. H, e cila ishte e parkuar , me ç’ rast me pjesën e pasme e godet atë, ku si pasojë e kësaj lartcekura person dëmtime të përkohshme të shëndetit si dhe janë shkaktuar dëme materiale.

-me çka ka kryer vepra penale : rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 1 lidhur me par 6 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurës konform nenit 41, 85, 86 dhe nenit 378 par 1 lidhur me par 6 të KPRK-së I SHQIPTON

VËREJTJE GJYQËSORE

Me të cilën të pandehurit i behët me dije se ka kryer veprë të dëmshme dhe të rrezikshme që përbënë veprë penale për të cilën nëse ai sërish e përsëritë gjykata do ti shqiptoi sanksion më të rëndë penal.

I pandehuri për shkak të gjendjes së varfër ekonomike lirohet nga pagimi i paushallit gjyqësor dhe i shpenzimeve të procedurës penale.

I dëmtuari për realizimin eventual e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.28.12.2016 kundër të pandehurit Sh. Shka ngritë aktakuzë PP/II. nr.1371/16, për veprë penale: rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 1 lidhur me par 6 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimi përkatësisht të mos pranimi të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarit , i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e sinqertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme , por edhe faktin i pandehuri është i gjendjes së varfër ekonomike dhe mbajtës i vetëm i familjes prej 7 anëtarësh e në veçanti faktin se bëhet fjalë për një aksident ku dëmtime materiale por edhe lëndimet janë gati krejtësisht minimale , dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 453 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.18.1.2018.

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .